REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

SHPALLJE PËR VEND VAKANTE NË POZICIONIN JURISTE DREJTORIA E POLICISË BASHKIAKE, BASHKIA LUSHNJE

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015"Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 64 , Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" ,i ndryshuar, Ligji Nr. 89/2022 "Për Policinë Bashkiake", Bashkia Lushnje hap proçedurën e shpalljes për pozicionin e lirë:

Jurist
Drejtoria e Policisë Bashkiake

Përshkrimi i përgjithshëm i vendit të punës :

Policia Bashkiake ka si mision ushtrimin e funksioneve në shërbim të sigurisë, qetësisë dhe rendit në komunitet, mbarëvajtjes së punëve publike, miradministrimit të hapësirave publike dhe mbrojtjes së mjedisit në territorin e juridiksionit të saj.

Është nëpunës me varësi direkte nga Drejtori i Policisë Bashkiake dhe ka këto detyra:

1. Realizon detyrat në bazë të ndarjes së brendshme të tyre nga drejtori i drejtorisë;
2. Përgatit përgjigjet për kërkesat e qytetarëve dhe institucioneve të ndryshme drejtuar Policisë Bashkiake;
3. Bën vlerësimin mbi ligjshmërinë e materialeve shkresore të dala nga drejtoria;
4. Ndjek zbatimin e detyrave që dalin nga aktet ligjore dhe nënligjore në veprimtarinë e Policisë Bashkiake;
5. Shqyrton dhe merr vendime për shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë ;

KUSHTET DHE KRITERET ;

- Kandidatët që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kritere:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të ketë përfunduar arsimin e lartë në Shkenca Juridike.
4. Niveli i edukimit Bachelor/Master Profesional/Shkencor;
5. Të ketë eksperiencë pune në profesion;
6. Të ketë aftësi për të zbatuar përgjegjësitë dhe realizimin e objektivave të institucionit;
7. Të jetë i përkushtuar dhe i komunikueshëm për zbatimin e detyrave;
8. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
9. Të mos jetë dhënë ndaj tij/saj masa disiplinore e largimit nga puna.

-Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumente :

Kërkesën për aplikim;

1. Jetëshkrimi (CV);
2. Fotokopje të diplomës dhe listës së notave;
3. Fotokopje të librezës së punës;
4. Fotokopje të kartës së identitetit;
5. Dëshmi penaliteti ose vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
6. Çertifikatë familjare;
7. Raport mjekësor që vërteton gjendjen shëndetësore;
8. Çertifikata të kualifikimeve(nese ka)
9. Referenca pune nga punedhenesi i fundit.
10. Vertetim gjykate
11. Vertetim prokurorie

Afati për dorëzimin e dokumenteve është data 19.01.2026 pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE